

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLIJE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#111

TAKIMI/ Juristët nga Diaspora të gatshëm të sjellin përvojën e tyre në Shqipëri



Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi aktivitetin online “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Diskutimi u zhvillua në tre panele: “Vështrim i përgjithshëm”, “Juristët në diasporë dhe roli i tyre në sistemin e drejtësisë” dhe “Rrjetëzimi dhe Ndërveprimi i Profesionistëve në diasporë”.

Gjatë fjalës së tij në këtë event, ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko tha se ky takim duhet parë si një mekanizëm që lidh të dyja palët, juristët jashtë vendit dhe ata në Shqipëri për një angazhim të përbashkët. Në fjalën e saj drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi u shpreh se Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kontribuojë në forcimin e urave lidhëse me Shqipërinë, për ta bërë më të lehtë bashkëveprimin me njëri-tjetrin.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë online për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike (pasaportë dhe ID) si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit

JURISTËT NË DIASPORË/ Majko: Angazhim i përbashkët për Shqipërinë

U zhvillua këtë të hënë Takimi i Juristëve në Diasporë, ku bëhet prezantimi i rrjetit të profesionistëve, angazhimi i profesionistëve në fushën e drejtësisë në Diasporë dhe ndërveprimi i tyre me juristët në Shqipëri është një ndër qëllimet kryesore të këtij event. Ministri Majko duke folur për rëndësinë e juristëve shqiptarë jashtë vendit tha se fjala e tyre ka nevojë për angazhim më të specifikuar kur bëhet fjalë për të drejtën e votës, marrëveshjet bilaterale që janë të lidhura me interesin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit siç janë marrëveshjet e pensioneve.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke formuar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë.

KOMISIONI SHQIPËRI-KOSOVË/ Ja kur nis aplikimi për Tekstet Mësimore të Diasporës



Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, në ditën e dytë të takimit që u mbajt në Durrës, diskutoi mbi procedurën e përzgjedhjes së recensuesve për vlerësimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën dhe për përmbajtjen e procesit të teksteve të përbashkëta nga Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës. Në përfundim të këtij takimi komisioni miratoi kalendarin e punës për përzgjedhjen e recensentëve dhe miratimin e thirrjes për aplikim të recensentëve të teksteve të përbashkëta për Diasporën.

Sipas vendimit të ditës së sotme thirrja për aplikime për tekstet e përbashkëta do të çelët më 14 qershor 2021 dhe do të zgjasë deri në 9 korrik 2021. Thirrja për aplikime do të jetë e aksesueshme në ëmbet dhe rrjetet sociale të 4 ministrive.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

TAKIMI/ Unifikimi i politikave të mësimdhënies në Diasporë mes Shqipërisë dhe Kosovës

Drejtues të lartë të institucioneve të Diasporës së Shqipërisë si dhe drejtues të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës zhvilluan sot një takim të rëndësishëm për unifikimin e politikave të mësimdhënies në Diasporë mes Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe vijimin e punës për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta në këtë fushë.

Në këtë takim u diskutua mbi rëndësinë e zbatimit të pikave që përmban neni 2 mbi: Organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgatë.



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Dhuo Libra



Nisma “Dhuo libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.